



VENDIM

Nr. 103, Datë 18.08.2015

**PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË LENGARICA & ENERGY SH.P.K. NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HEC “LENGARICA” (ME FUQI TË INSTALUAR 8.94 MW)**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5 pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 18.08.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “LENGARICA & ENERGY”sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “LENGARICA & ENERGY”sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojë shoqërinë “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k, në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec “LENGARICA” me fuqi të instaluar 8.94 MW, për një afat 30 – vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Liçensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI